



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

URDHËR

NR. 6792/5 / DATË 01/11 / 2012
PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR KONTRAKTIMIN E NJË KONSULENTI
NDËRKOMBËTAR PËR RASTIN E CEZ SHPËRNDARJE, QË DO TË ASISTOJË
ENTIN RREGULLATOR TË ENERGJISË (ERE)**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë“, i ndryshuar, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, si dhe të paragrafit 1, të nenit 18, të Rregullores bashkëlidhur vendimit nr. 392, datë 08.04.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e Avokatëve të Shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale”,

KONSTATOJ SE:

Enti Rregullator i Energjisë, me shkresën nr. 683/3 Prot., datë 31.10.2012, ka kërkuar nga Avokatura e Shtetit fillimin e procedurave ligjore për përzgjedhjen e një konsulenti ndërkombëtar, i cili do të kishte mundësi reale të ofronte konsulencë të kënaqshme në fushën e licencimit në sektorin energjetik, në përputhje me Kreun IV të vendimit nr. 392, datë 08.04.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e Avokatëve të Shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale”. Avokatura e Shtetit, pasi ka shqyrtuar rastin, me shkresën nr. 1705/9 Prot., datë 31.10.2012 drejtuar Ministrit të Drejtësisë, ka kërkuar kontraktimin e një konsulenti, për të ofruar konsulencë për Entin Rregullator të Energjisë, me qëllim asistimin për arritjen e një marrëveshje me shoqërinë CEZ Shpërndarje sh.a.. Kërkesës së Avokaturës së Shtetit drejtuar Ministrit të Drejtësisë, i bashkëngjitet edhe kërkesa e titullarit të administratës publike për kontraktimin e një konsulenti (*shkresa nr. 683/3 Prot., datë 31.10.2012 e Kryetarit të Entit Rregullator të Energjisë*).

Duke mbajtur në konsideratë vlerësimet e bëra në shkresën nr. 1705/9 Prot. , datë 31.10.2012 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit dhe shkresën nr. 683/3 Prot., datë 31.10.2012 të Kryetarit të Entit Rregullator të Energjisë, ku specifikohet nevoja e kontraktimit të një konsulenti



ndërkombëtar për të asistuar Entin Rregullator të Energjisë për rastin e CEZ Shpërndarje, vlerësoj se:

- 1- kjo çështje është me rëndësi të veçantë për interesat e shtetit dhe për moscenimin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve tariforë.
- 2- kjo çështje është shumë e vështirë për t'u ndjekur nga Avokatura e Shtetit, për shkak të kompleksitetit shumë të madh të çështjes, si dhe nevojës për njohuri mbi praktikën ndërkombëtare në fushën e licencimit në sektorin e energjisë.
- 3- për këtë çështje organi i administratës publike (*Enti Rregullator i Energjisë*) ka çmuar të paraqesë kërkesë për fillimin e procedurave ligjore për përzgjedhjen e një konsulenti, i cili do t'i asistojë dhe ndihmojë lidhur me rastin e CEZ Shpërndarje.

NË KËTO KUSHTE:

Pas miratimit të kërkesës së paraqitur nga Enti Rregullator i Energjisë, nëpërmjet shkresës nr. 683/3 Prot., datë 31.10.2012, në përputhje me ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", si dhe paragrafin 1, të nenit 18, të Rregullores bashkëlidhur vendimit nr. 392, datë 08.04.2009 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores "Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e Avokatëve të Shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale", ku përcaktohet se: *"Pas miratimit të kërkesës, Ministri i Drejtësisë nxjerr urdhër për fillimin e procedurave për kontraktimin e avokatëve/zyrave të avokatisë në profesion të lirë, duke përcaktuar, për çdo rast, nevojën e kontraktimit, kushtet e veçanta që duhet të plotësohen nga avokatët apo zyrat e avokatisë, objektin e punës/llojet e shërbimeve të kërkuara, si dhe përbërjen e komisionit për ndjekjen e procedurave"*,

URDHËROJ:

1. Fillimin e procedurave për kontraktimin e një konsulenti ndërkombëtar, për t'i ofruar Entit Rregullator të Energjisë konsulencë në fushën e licencimit në sektorin elektroenergjetik, duke qenë se kjo çështje ka një natyrë të veçantë dhe të ndërlikuar juridike, si dhe kërkon njohuri të specializuar në fushën ligjore dhe financiare në sektorin elektroenergjetik.
2. Objekti i punës, si dhe llojet e shërbimeve të kërkuara nga konsulenti, janë sipas Aneksit 1 "Termat e Referencës", bashkëlidhur këtij urdhri, të paraqitura nga Enti Rregullator i Energjisë. Kriteret e përgjithshme dhe kushtet e veçanta, për përzgjedhjen e konsulentit janë sipas Aneksit 2 bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Ndjekja e procedurave për përzgjedhjen e konsulentit ligjor, si dhe hartimi i dokumentacionit përkatës, bëhet nga Komisioni Përzgjedhës i përbërë nga:

Për arsye të ruajtjes së konfidencialitetit dhe paanësisë në vendimmarrjen e Komisionit Përzgjedhës, emrat e anëtarëve të Komisionit nuk do të bëhen publike, deri në momentin e hapjes së ofertave të paraqitura. Ndërkohë që dokumentat origjinale të nënshkruara nga anëtarët e Komisionit gjenden të depozituara me shënimin "*Konfidenciale*", në Sektorin e Arkiv-Protokollit, pranë Ministrisë së Drejtësisë.

4. Komisioni Përzgjedhës gjatë ushtrimit të veprimtarisë udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë dhe zhvillon procedurën konkurruese në përputhje me këto parime të përgjithshme:
- a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë;
 - b) transparencë në procedurat konkurruese;
 - c) barazi në trajtimin e ofertave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen kandidatëve që paraqesin konfirmim për vazhdimin e negociatave dhe oferta për realizimin e shërbimit.
5. Detyrat kryesore të Komisionit Përzgjedhës, por pa u kufizuar vetëm në to, janë:
- a) Të përgatisë Ftesën për Negociata brenda 5 ditëve nga dalja e këtij Urdhri;
 - b) Të shqyrtojë ofertat e paraqitura, të përgatisë raport të hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur, kandidatët që kanë marrë pjesë dhe konsulentin e përzgjedhur;
 - c) T'i paraqesë Ministrit të Drejtësisë raportin e hollësishëm në lidhje me procedurën e ndjekur, së bashku me klasifikimin përfundimtar të kandidatëve sipas pikëve dhe praktikën e plotë për të marrë vendim;
 - ç) Të kryejë çdo veprim apo përgatisë çdo dokument tjetër të nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit.
6. Komisioni, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, u shpërndan, me korrespondencë zyrtare në rrugë elektronike, kandidatëve për konsulentë, Ftesën për Negociata.
7. Ftesa për Negociata publikohet edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Entit Rregullator të Energjisë, dhe duhet të përmbajë:
- a) Specifikimin e objektit dhe llojit të shërbimit të kërkuar;
 - b) Nevojën e kontraktimit të konsulentit ligjor,
 - c) Kriteret e përgjithshme e të veçanta që duhet të plotësohen nga konsulenti ligjor; si dhe
 - ç) Datën përfundimtare të pranimit të kërkesës nga të interesuarit.
8. Komisioni pret konfirmimin nga konsulentët, për vazhdimësinë e negociatave, brenda afatit të fundit të paraqitur, të përcaktuar në Ftesën për Negociata.
9. Konsulentët, konfirmimin për vazhdimësinë e negociatave, duhet ta shoqërojnë me propozimin për çmimin përkatës për kryerjen e shërbimeve të këshillimit.
10. Konfirmimet për vazhdimësinë e negociatave vijnë të mbyllura në adresën e specifikuar në ftesën për negociata dhe hapen njëkohësisht, në prani të anëtarëve të komisionit në një ditë të vetme, e cila njoftohet paraprakisht nga Komisioni.
11. Pas hapjes dhe analizimit të ofertave, të paraqitura nga kandidatët për konsulentë, Komisioni përzgjedh, në bazë të pikëve, konsulentin, duke u bazuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në këtë urdhër dhe në Ftesën për Negocim.



12. Brenda 2 ditëve nga përfundimi i procedurës së përzgjedhjes, Komisioni harton një raport të hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur, kandidatët për konsulentë që kanë marrë pjesë dhe konsulentin e përzgjedhur, të cilin ia paraqet Ministrit të Drejtësisë, së bashku me klasifikimin përfundimtar të kandidatëve për konsulentë sipas pikëve.

13. Raporti i hollësishëm sipas pikës 12 të këtij urdhri, i njoftohet njëkohësisht kandidatëve që kanë marrë pjesë, si dhe Entit Rregullator të Energjisë.

14. Brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të raportit, konsulentët ligjor të interesuar apo Enti Rregullator i Energjisë mund të ankohen lidhur me procedurën e përzgjedhjes, duke paraqitur ankim me shkrim drejtuar Ministrit të Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë shprehet me vendim lidhur me ankesën, brenda 2 ditëve nga marrja e saj, dhe njofton ankuesin dhe Entin Rregullator të Energjisë me shkrim.

15. Vendimi për vlefhtësimin e procedurës së përzgjedhjes dhe shpalljen e fituesit, i njoftohet konsulentit që shpallet fitues, Entit Rregullator të Energjisë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

16. Një kopje e këtij urdhri i njoftohet menjëherë Entit Rregullator të Energjisë dhe Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

17. Ngarkohet Komisioni Përzgjedhës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

EDUARD HALEMI



Telefon: + 355 4 22 33 591
Faks: + 355 4 22 33 591

Termat e Referencës për asistencë ligjore

1. Hyrje

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) është institucion publik që është krijuar dhe funksionon sipas Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9946, datë 30.06.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, i cili është përgjegjës për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike dhe atij të gazit natyror. Me ndermarrjen e politikave liberalizuese për përfshirjen e investitorëve private në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike, por sidomos me privatizimin e sektorit të shpërndarjes së energjisë elektrike, rregullimi i sektorit të energjisë kërkon gjithmone e me shume një ekspertizë të lartë profesionale. Në vitin 2009, shteti shqiptar vendosi privatizimin e 76% të aksioneve të shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a) aksione, të cilat u blenë nga shoqëria çeke CEZ AS kundrejt cmimit prej 102 milion Euro.

Vetë procesi i privatizimit mbështetet kryesisht në dy marrëveshje baze, ajo e shitblerjes së aksioneve të shoqërisë OSSH sh.a ratifikuar nga Kuvendi me anë të Ligjit nr. 10 116, datë 23.4.2009 “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a.-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe ÇEZ a.s.-së” dhe marrëveshja e mbështetjes qeveritare ratifikuar nga Kuvendi me anë të Ligjit nr. 10 123, datë 11.05.2009, “Për Miratimin e Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për Garantimin e Projektit të Privatizimit të OSSH sh.a”. Përveç dy marrëveshjeve të sipërmendura, procesi i privatizimit të shoqërisë së shpërndarjes është shoqëruar edhe me akte të ndryshme nënligjore të nxjerra nga ERE, kushtet e licensave që ERE ka leshuar për shoqëri private, Deklarata Rregullatore etj, të cilat përbejnë kuadrin ligjor që do të merret në konsideratë në trajtimin e pretendimeve që shoqëria private CEZ do të ketë dhe në arritjen e një marrëveshjeje mirekuptimi ndërmjet kesaj të fundit me shtetin shqiptar.

Vlen të theksohet që marrëveshja e mbështetjes qeveritare parashikon vendosjen e një garancie prej 60 milion dollar nga ana e Ministrisë së Financave (shtetit shqiptar) për të mbuluar çdo dëm financiar që do të shkaktonte shoqëria CEZ Shpërndarje nga



vendimet e pambeshtetura te ERE-s, garanci e cila do te ekzekutohej nepermjet Bankes Nderkombetare per Zhvillim (IBRD), nderkohe qe te dyja marreveshjet e sipermendura parashikojne te drejten e investitorit privat qe t'i drejtohet arbitrazhit nderkombetar ne rast te ndonje mosmarreveshje apo konflikti te mundshem ndermjet paleve.

Per arsye te performances jo shume te mire te kompanise private CEZ Shperndarje, sidomos gjate vitit 2012 situata financiare e kesaj kompanie dhe e pothuajse te gjithe sektorit te energjise elektrike ne vend eshte perkeqesuar. Kompania CEZ Shperndarje si pasoje e veshtiresive financiare me te cilat eshte ndeshur i ka parashtruar Qeverise Shqiptare nje sere kushtesh te cilat jane konsideruar nga Qeveria si jo te mbeshtetura dhe per pasoje jo te mundshme per t'u plotësuar. Ne këtë kuadër, kompania CEZ Shperndarje ka propozuar marrjen ne konsiderate nga ana e Qeverise edhe mundësinë e arritjes se nje marreveshje mirekuptimi per te shmangur nje konflikt te mundshem ligjor dhe te nje zgjidhje nepermjet aktivizimit te arbitrazhit nderkombetar.

Ne negociimin e nje marreveshjeje te mundshme dhe te pranueshme per CEZ Shperndarje dhe shtetin shqiptar, per vete autoritetin dhe kompetencat qe ERE ka patur dhe ka lidhur me rregullimin e aktivitetit te kompanise CEZ Shperndarje dhe sidomos lidhur me moscenimin e sigurise dhe cilesise se sherbimit te furnizimit me energji elektrike te konsumatoreve dhe ekonomise se vendit, pritet qe ERE te luaje nje rol te rendesishem ne interpretimin e akteve ligjore dhe nenligjore qe kane te bejne me procesin e post-privatizimit dhe rregullimin e aktivitetit te shperndarjes dhe furnizimit me pakice si dhe ne arritjen e nje marreveshjeje te drejte dhe te pranueshme per shtetin shqiptar dhe investitorin cek.

Ne keto kushte, ERE ka nevojë dhe kërkon te kontraktoje per llogari te saj një studio avokatie me eksperience ne fushat e te drejtës civile, te drejtës tregtare dhe biznesit, politikave publike, te drejtës ndërkombëtare tregtare, te drejtës se burimeve natyrore dhe energjetike, legjislacionit mbi investimet, përfshirë dhe atë te arbitrazhit ndërkombëtar, e cila do te mbështesë institucionin me këshillimet e nevojshme juridike.

2. Objekti i punës

Objekti i punës se zyrës ligjore do te përfshijë:



- Këshillimin e ERE-s dhe stafin e saj lidhur me çdo aspekt të natyrës ligjore lidhur me aktivitetin e kompanisë së privatizuar të shpërndarjes;
- Të këshillojë ERE-n lidhur me hapat e nevojshëm ligjore dhe administrative që duhen ndërmarrë për arritjen e një marrëveshje të pranueshme për shtetin shqiptar dhe investitorin e huaj;
- Të analizoje dhe të këshillojë ERE-n lidhur me riskun potencial (financiar, por jo vetëm), që do të shoqëronte një mosarritje të mundshme e një marrëveshjeje mirekutpimi;
- Të këshillojë ERE-n lidhur me zbatimin e dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare që mundësojnë implementimin në praktike të një marrëveshjeje të mundshme ndërmjet aksionarit të shumicës (CEZ AS) dhe atij të pakicës (METE);
- Të propozojë alternativa të tjera ligjore dhe me efekte sa më minimale financiare për shtetin shqiptar në rast se është e nevojshme për shkak të dështimit në arritjen e një marrëveshjeje të pranueshme ndërmjet palëve;
- Të ndihmojë në përgatitjen dhe shqyrtimin e të gjitha akteve apo projekt-vendimeve, përfshirë korrespondencën zyrtare me shoqërinë CEZ Shpërndarje dhe aksionerin e saj të shumicës (CEZ AS), që ERE do të duhet të marrë në kuadrin e këtij procesi;
- Të asistojë/drejtojë drejtpërdrejtë me kërkesë të kontraktuesit në negociimet me CEZ Shpërndarje sh.a apo me çdo përfaqësues të zgjedhur prej kësaj të fundit për qëllime të negociimit me ERE-n.
- Të asistojë/drejtojë drejtpërdrejtë me kërkesë të kontraktuesit në negociimet e përbashkëta që mund të zhvillohen me METE për qëllime të arritjes së një marrëveshjeje midis palëve në proces.

3. Kriteret e përzgjedhjes së Zyres ligjore

Zyra ligjore duhet të ketë një eksperience ndërkombëtare dhe duhet të verë në dispozicion të ERE-s për shërbimet e kërkuara dy ose më shumë juriste me jo më pak se 10 vjet eksperience pune në fushën e të drejtës civile, të drejtës tregtare dhe biznesit, politikave publike, të drejtës ndërkombëtare tregtare, të drejtës së burimeve natyrore dhe energjetike, legjislacionit mbi investimet, përfshirë dhe atë të arbitrazhit ndërkombëtar, e cila do të mbështesë institucionin me këshillimet e nevojshme juridike.



4. Konfidencialiteti dhe konflikti i interesit

Zyra ligjore do të garantojë konfidencialitetin tek palet e treta lidhur me çdo informacion me të cilin ajo mund të vihet në dijeni gjatë kryerjes së shërbimeve ligjore apo shërbimeve të tjera të konsulences si dhe të mos ketë asnjë element të një konflikti të mundshëm interesash për kryerjen e shërbimeve që kërkohen.

5. Afati

ERE synon që Zyra ligjore të kontraktohet për një afat i cili do të korrespondojë arritjes së marrëveshjes ndërmjet shtetit shqiptar dhe investitorit privat.

6. Fondi

Fondi për shërbimet në kuadrin e këtij shërbimi, do të mbulohet plotësisht nga buxheti i ERE-s.

7. Kontrata

ERE dhe Studio Ligjore do të nënshkruajnë një kontratë shërbimesh ligjore në të cilën do të përcaktohen edhe mënyra e komunikimit, personat e kontaktit dhe aspekte të tjera të kësaj marrëdhënie.



ANEKSI 2

KRITERET E PËRGJITHSHME DHE KUSHTET E VEÇANTA PËR PËRZGJEDHJEN E KONSULENTIT

I. Kriteret e përgjithshme, për përzgjedhjen e konsulentit janë:

1. Specialiteti i konsulentit ligjor në fushën ligjore dhe financiare në sektorin elektroenergjetik;
2. Përvoja e konsulentit ligjor në fushën e këshillimit dhe njohuri mbi praktikën ndërkombëtare në fushën e licencimit në sektorin e energjisë;
3. Besueshmëria dhe reputacioni i avokatit/zyrës së avokatisë.

II. Kushtet e veçanta, për përzgjedhjen e konsulentit janë sipas Termave të Referencës të dërguara nga Enti Rregullator i Energjisë dhe që i bashkëlidhen këtij urdhri.

